

Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vendin vakant për Specialist i Sektorit të Projekteve Shkencore dhe Profesionale në Drejtorinë e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, si më poshtë:

Kriteret për kandidim janë:

Kritere të veçanta që duhet të plotësojë kandidati për Specialist i Sektorit të Projekteve Shkencore dhe Profesionale.

- a) Të zotërojë diplomë të Universitare Master Profesional ose Master Shkencor në një nga fushat e arsimit të lartë.
- b) Të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune.
- c) Të zotërojë gjuhën e huaj Anglisht të vërtetuar me dëshminë përkatëse.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Specialist i Sektorit të Projekteve Shkencore dhe Profesionale.

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- c) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **14.04.2021** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimi (CV);
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
- Fotokopje e diplomës universitare dhe listës së notave të noterizuara;
- Fotokopje e librezës së punës (në të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, dëshmi e gjuhës së huaj etj. (nëse ka);
- Dëshmi e penalitetit ose formular vetëdeklarimi;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore.